

Dr. Drita Bakia — Gunga

HEQJA E ÇARÇAFIT DHE E PEÇES NË KOSOVË

Në periudhat historiko-shoqërore, një ndër format e mohimit të drejtave njerëzore elementare dhe të lirisë së femrës, ishte edhe detyrimi i mbajtjes së çarçafit dhe të peçës. Dukuria ose zakoni i mbajtjes së çarçafit nuk ishte normë e religjionit mysliman a të krishter. Rrënjët e veta i ka qysh në kohët më të vjetra.¹ Por, në thelb dhe në përgjithësi ishte një nga format e shtypjes dhe të shfrytëzimit të femrës, kudo që u manifestua.

Gjatë zhvillimit të njerëzimit, në etapa të ndryshme, këtë zakon nënçmues për femrën e përdoren si mjet regjimet e ndryshme, robëruese, për ta mbajtur nën zgjedhë më lehtë gjysmën e popullsisë në vende të ndryshme. Më pak ose më shumë mbronte interesat e klasave sunduese, sipas botëkuptimit, duke pasur mbështetje politiko-shoqërore, etike dhe klasore, që ato kishin ndaj shtresave të shtypura. Bie fjala, te hebrenjtë vetëm femrat e fejuara e mbulonin fytyrën, ndërsa te persianët ato të shtresave të larta, për t'u dalluar, sipas tyre, nga turmat e pavlera të popullit.²

Kur turqit formuan Perandorinë Osmane, zakonin e mbulimit të fytyrës e pranuan po ashtu nga këto treva. Mbulesa e fytyrës së femrës-peçja, me kohë e ndërron formën, duke iu shtuar edhe një pjesë tjetër e veshjes-çarçafi.

¹ Të mbuluarit e fytyrës së femrës te popujt e Lindjes së Afërme u praktikua dhe, pastaj u aplikua, shumë kohë para lindjes së krishtërit. Ky zakon duket te femra çifute, persiane, egjiptiane dhe siriane, e më vonë edhe te grekët e vjetër (Penelopa ndër pretenduesit e saj paraqitet me fytyrë të mbuluar), tek arabët e, më vonë, edhe te turqit. Filozofi kristian, Tertuliani, i frymëzuar nga dukuria dhe zakoni i mbulimit të fytyrës te femrat e popujve të Lindjes së Afërme në fillim të shekullit VII, në veprën e tij „*DE VERINIBUS VELANDIS*”, këshillonte dhe njëkohësisht urdhëronte në predikimet e tij, që në mbledhjet krishtere virgjineshat duhet të mbajnë mbulesë në fytyrë ashtu sikurse femrat në Lindjen e Afërme. Ndërkaq, në kohën e Muhamedit te femrat myslimane zakoni i mbulimit të fytyrës ende nuk kishte depërtuar. Gratë arabe në këtë kohë ishin mjaft aktive në jetën e përgjithshme shoqërore, politike dhe kulturore dhe në këtë drejtim nuk kishte dallim të dukshëm ndërmjet mashkullit dhe femrës. Gruaja e Muhamedit-Ajshja, sipas të dhënave, ushtronte veprimtari të gjallë në jetën shoqërore dhe më vonë dallohet poetesha Fadi, e shekullit IX. e cila la vepra të njohura në letërsinë arabe. „(Rilindja”, 5 mars 1951).

² Po aty.

Me pushtimin e Ballkanit, pra edhe të viseve të Jugosllavisë, nga Turqia, një nga format e shtypjes së popujve të pushtuar ishte edhe aplikimi i zakonit të veshjes së çarçafit dhe të peçës ndër femra. Ky zakon u imponua sidomos në ato vende dhe vise dhe ndër popujt që e pranuan fenë islame, si: në Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni, në Serbinë Jugore dhe në Kosovë. Kështu, te shqiptarët veshja e çarçafit paraqitet diku nga mbarimi i shekullit XIX, sidomos në qytete dhe në mjedise që shërbenin si qendra ushtarake, siç ishte: Peja, Mitrovica, Prizreni etj.³

Feja islame e ndau gruan plotësisht nga shoqëria duke e mbyllur në shtëpi në mes të katër mureve. Ajo në radhë të parë e mbylli në çarçaf dhe e mbuloi me peçe, duke goditur rëndë ndjenjat aspiratat dhe dinjitetin njerëzor të saj. Me një fjalë gruan e ktheu në shkallë të skillavit.

Përkrahësit e sundimit Osman, sidomos kleri, ndihmuan — duke u nisur edhe nga pozitat shoqërore dhe politike-pushtuesin për robërimin më të madh të femrës shqiptare në radhët myslimane, e cila në këto raporte shoqërore, ekonomike dhe politike jetonte në një shkallë të ulët të zhvillimit kulturor, ekonomikisht e varur dhe pa kurrfarë të drejtash. Në këtë drejtim, duhet konstatuar se kontribuan klerikët naivë myslimanë dhe masat e gjera të pashkolluara, të cilat këtij zakoni i dhanë ngjyrë dhe domethënie fetare. Por, veshjen e çarçafit dhe të peçës femrat shqiptare të krishtera dhe ortodokse nuk e pranuan, meqë kleri katolik dhe ortodoks ishte në kundërshtim me ideologjinë dhe fenë e Perandorisë Osmane.⁴

Mirëpo, kjo veshje nuk u përhap dhe nuk u përkrah në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin intensitet. Te femra shqiptare fshatare myslimane, u paraqit më vonë sesa në qytet për arsye se sundimi turk në këto mjedise ishte më i dobët. Depërtimin e vonshëm të këtij zakoni te femra në mjediset fshatare e pengonte edhe faktori ekonomik, sepse femra fshatare, për dallim nga ajo e qytetit, luante rol të rëndësishëm, ndër të tjera, edhe si fuqi prodhuese.

Përveç punëve shtëpiake dhe edukimit të fëmijëve, femra fshatare angazhohej edhe për kryerjen e punëve bujqësore dhe blegtorale, e kjo do të thotë se pranimi i një zakoni të këtillë do të kufizonte fuqinë punëtore në fshat dhe do të manifestoheshin edhe pasojat ekonomike. Prandaj, zakoni i mbulimit të gruas në pjesën fshatare të popullsisë, edhe atë herë kur filloi depërtimi dhe përvetësimi i tij, nuk u përhap në çdo pjesë të Kosovës e në çdo mjedis të saj në mënyrë të barabartë dhe në të njëjtën kohë e në të njëjtën masë. Për këtë flasin edhe të dhënat se në fshatrat e trevës së rrafshit të Kosovës depërtoi së pari, pikërisht për shkak të kushteve dhe të pozitës, ndërsa në Rrafshin e Dukagjinit dhe sidomos, në Malësi, pothuaj nuk arriti të përhapej fare. Por, me kohë, përkundër rezistencave të ndryshme, çarçafi dhe peçja, në një pjesë bukur të mirë shtrin rrënjët dhe bëhet zakon për femrat myslimane të Kosovës.

³ Drita Gunga, (punim i magistraturës, 1977).

⁴ Po aty; Si shën. 1.

Në kohën e Jugosllavisë borgjeze çarçafin e peçen si formë e shtypjes së femrës e përkrah edhe më tepër regjimi antipopullor. Femrat përparimtare të kësaj kohe me anë të lutjeve dhe protestave të ndryshme dërguar oborrit mbretëror, kërkonin që të hiqnin çarçafin ose të gjendej ndonjë formë për zhdukjen e tij. Ato i drejtohen edhe mbretëreshës Maria, duke i treguar gjendjen e vështirë nën çarçaf, kërkojnë prej saj që të gjenden mënyrat për t'u liruar nga çarçafi, sepse, siç thonë ato, „po bëhemi robër të vërtetë të paedukuar”, duke iu lutur asaj që të nxirret ligji, i cili „reptësisht do të ndalojë që të jenë nën çarçaf, sepse duam të jemi të zbuluara dhe të edukuara”.⁵

Dëshira e tyre u realizua me Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe Revolucionin Socialist dhe pas tij, kur Pushteti Popullor, i udhëhequr nga PKJ, e sidomos intelijenca shqiptare, kërkojnë që të zhduket ky zakon prapanik dhe nënçmues për femrën, e cila në kushte të reja shoqërore duhej të bëhej faktor i rëndësishëm i shoqërisë së re socialiste.⁶

Deri në prag të çlirimit gruaja në Kosovë, sidomos ajo shqiptare, ende ishte viktimë e zakoneve patriarkale të kodifikuara nga kanuni dhe ligjet në fuqi dhe si e tillë ishte pjesa më e shfrytëzuar dhe më e paarsimuar. Në kushtet e pushtimit fashist gruaja ishte trefish e shtypur, nga fashizmi, nga klasa borgjeze dhe nga zakonet e ligjet skllavëruese, reaksionare në bashkëpunim me fenë.⁷

Kur gruaja trajtohej në shoqëri e familje si qenie inferiore, pa të drejta, kur shtypej në përgjithësi politikisht, ekonomikisht dhe në pikëpamje shoqërore duke u mbrojtur nga institucioni i kanunit dhe një sërë ligjesh të shkruara e të pashkruara. Partia Komuniste e Jugosllavisë jo vetëm e mori në mbrojtje gruan, jo vetëm i tregoi asaj rugën e çlirimit të vërtetë njerëzor nga zgjedhja e rëndë, por, duke i bërë thirrje asaj që të hyjë në rrjedhën e Revolucionit Popullor, ia bëri të qartë se lufta për emancipimin e saj politik e shoqëror ishte e pandarë nga ky Revolucion dhe lufta klasore.⁸

Njëri ndër aksionet e para të Pushtetit Popullor për emancipimin e femrës shqiptare fill pas çlirimit ishte lufta për heqjen e çarçafit dhe të peçës në Kosovë.

Bartësit kryesor të këtij aksioni ishin njerëzit përparimtarë dhe forcat progresive të udhëhequra nga PKJ. Mirëpo, që në ditët e para aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës hasi në rezistencë dhe pengesa të mëdha të shtresat e gjera, në mendjen e të cilave kishin zënë rrënjë paragjykimet dhe botëkuptimet konservatore lidhur me pozitën e gruas.

⁵ AJ-Fondi, DVOR, lutje (këtë lutje mbretëreshës Maria — gruas së Aleksandar Karagjorgjeviqit, ia dërguan femrat shqiptare nga Dibra në vitin 1937.

⁶ „Rilindja”, 7 mars 1951.

⁷ Sulltane Kojqini, (punim i magistraturës 1977).

⁸ V. Tomsić, *Zena u razvoju socijalističke samoupravne Jugoslavije*, Beograd, 1975.

Kërkesa për heqjen e çarçafit dhe të peçës u shtrua si çështje që kërkonte zgjidhje të ngutshme nga vetë femrat përparimtare të kohës. Sepse vazhdimi i mëtutjeshëm i bartjes së çarçafit dhe të peçës ishte bërë në kushte të reja shoqërore pengesë për përparimin e domosdoshëm të femrës shqiptare, e cila tani duhej të ecte krah për krah me shoqet e saj të popujve të tjerë të Jugosllavisë. Që nga viti 1946 kësaj çështjeje iu dha vend në shtyp, radio, konferenca të ndryshme të organizatës së FAG-ut, që u bënë në shumë mjedise të krahinës sonë.⁹

Në raportin e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë e Метохи për vitin 1947 thuhet, ndër të tjera, se në aksionin për heqjen e çarçafit organizatat e Partisë arritën suksese të dukshme nëpër disa rrethe. Numri i femrave shqiptare që e hodhën çarçafin dhe peçen ishte afër 25.000 veta. Mirëpo, reaksioni me të gjitha forcat u përpoq ta pengonte këtë aksion. Për këtë ata shfrytëzuan prapambetjen dhe pozitën e vështirë në të cilën gjendej femra në krahinën tonë dhe në viset e tjera të banuara me shqiptarë. Meqenëse femrat ishin shtresa më e paarsimuar e shoqërisë, reaksioni ia arriti qëllimit që të ketë ndikim tek ato, sepse, në radhë të parë, organizatat e Partisë, Fronti Popullor dhe ajo e Gruas, çështjen e aksionit për heqjen e çarçafit e të peçës nuk e kuptoi sa duhet dhe nuk i kushtoi rëndësi të duhur.

Gjatë vitit 1947 forcat e organizuara subjektive politiko-shoqërore çështjen e aksionit për heqjen e çarçafit dhe të peçës e kuptuan si çështje të përkohshme, e jo si një çështje të punës dhe të luftës për një aktivitet më afatgjatë. Nuk u luftua në mënyrë permanente kundër të gjitha formave të reaksionit. Prandaj, si rezultat i punës së pamjaftueshme me gra në këtë kohë, rrjedh se një numër bukur i mirë i grave, duke rënë nën ndikimin e propagandës armiqësore, pasi e hoqën çarçafin, përsëri u mbuluan.

Në zgjedhjen e këtij problemi, dobësitë ishin të pranishme në vetë organizimin e aktivitetit në organizatën e Partisë të komiteve të rretheve dhe të anëtarëve të Partisë, që në raste u bënë edhe vetë pengesë për zbatimin e aksionit. Madje, disa prej tyre në forma të ndryshme kundërshtuan që t'i zbulojnë gratë dhe motrat e tyre. Po ashtu, ndër faktorët që ndikuan në mosrealizimin e plotë të këtij aksioni është edhe fakti se në Organizatën e FAG-ut në këtë kohë nuk ekzistonte një plan më i përpunuar, i cili do t'i përcaktonte detyrat kryesore. Puna e FAG-ut lidhur me këtë çështje ishte e njëanshme dhe kryesisht përkufizohej në udhëheqjen e disa aktiviteteve në mënyrë të shkëputur. Nga të dhënat del se edhe komitetet e rretheve nuk i kushtuan kujdes të duhur punës me gra, e sidomos punës në ngritjen ideore në radhët e femrave shqiptare.¹⁰

Mentaliteti primitiv, paragjykimet që kishin zënë rrënjët të thella, lidhur me pozitën e gruas në masat e gjera popullore dhe propaganda e reaksionit në shumë mjedise të Krahinës penguan mjaft aksionin për heqjen e çarçafit dhe të peçës gjatë vitit 1947.

⁹ „Jedinstvo”, Prizren, mars 1946.

¹⁰ AIHK, OKKM, sig. 690, nr. i dok. 2630.

Kështu, në Gjilan armiku përdori parulla të ndryshme, ndër të tjera, ishin: „Femrat e zbuluara do t'i detyrojnë të punojnë jashtë vendit, sesi zbulimi i femrës është kundër fesë, se gjoja ky aksion është dëshirë e individëve e jo e shtetit” etj.¹¹ Mirëpo, gratë përparimtare të Pejës, nëpërmjet organizatës së tyre, shfrytëzuan ato femra te të cilat vetëdija ishte më e ngritur për të ndikuar te femrat e tjera për heqjen e çarçafit. Kjo formë pune dha rezultatet e para dhe, që në vitin 1947, numri i grave të zbuluara në Pejë arriti deri në 80 veta. Meqenëse nuk patën përkrahjen e plotë të forcave progresive, shpejt ranë nën ndikimin e propagandës së reaksionit dhe përsëri u mbuluan.¹²

Mirëpo, për mossuksesin e aksionit dobësitë shpeshherë ishin edhe në vetë Organizatën e FAG-ut. Kështu, bie fjala, në Mitrovicë kjo organizatë, në kohën e zbatimit të aksionit, nuk u tregua aspak aktive, prandaj edhe aksioni nuk dha pothuajse kurrfarë rezultati. Këto dobësi u paraqiten edhe tek organizatat e tjera politiko-shoqërore, të cilat me këtë rast nuk i dhanë ndihmë të nevojshme Organizatës së Gruas.¹³ Në këtë kohë ky problem i rëndësishëm u vu edhe para Organizatës së FAG-ut të rrethit të Istogut dhe të Lipjanit. Në filllet e veta aksioni pati sukses: në Istog çarçafin e hoqën afro 1866 femra, ndërsa në Lipjan 180, mirëpo, së shpejti, ky numër u pakësua, pikërisht pse aksioni ishte formal, sepse puna në ngritjen ideore të grave ishte e dobët, gjë që i bëri të mundur propagandës reaksionare të ketë ndikim në masat e gjera.¹⁴ Aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës në Podujevë pothuajse nuk e përkrahen as shumica e anëtarëve të Partisë, të cilët kundërshtuan që t'u hiqen çarçafi grave dhe motrave të tyre. Gjatë këtij viti në Podujevë çarçafin e hoqën vetëm 5 femra, kryesisht këto ishin motrat dhe gratë e anëtarëve të Partisë. Qëndrimi i vetë anëtarëve të Partisë ndaj këtij problemi, ndihmoi reaksionin e në radhë të parë, klerin që të pengonte realizimin me sukses të aksionit.¹⁵

Rol të rëndësishëm për realizimin e këtij aksioni ushtroi edhe Komiteti Shqiptar. Në një sërë mbledhjesh që u bënë në shumë mjedise të Kosovës u fol për rëndësin e heqjes së çarçafit dhe të peçës. Këto tubime dhanë edhe rezultate. Të bindura për ato që u fol në mbledhjen e Komitetit Shqiptar të Rahovecit, në të gjitha fshatrat e këtij rrethi e hoqën çarçafin përafërsisht 2300 gra e vajza shqiptare.¹⁶ Me vendosmërinë e tyre në këtë aksion u dalluan femrat e Prizrenit dhe të Gjakovës. Ato e hoqën në mënyrë masive, pas mbledhjeve të FAG-ut, të cilat u shëndërruan në meetingje, ku gratë më përparimtare protestonin kundër mbajtjes së çarçafit. Ato më të guximshmet menjëherë e hodhën poshtë këtë veshje e në mesin e tyre kishte shumë të tjera që kishin dëshirë ta ndiqnin rrugën e këtyre grave përparimtare, por ende ishin nën pushtetin

¹¹ AIHK, OKKM, sig. 691, nr. i dok. 2630.

¹² AIHK, OKKM, sig. 641, 675.

¹³ AIHK, OKKM, sig. 693, nr. i dok. 2633.

¹⁴ AIHK, OKKM, sig. 677, 678.

¹⁵ AIHK, OKKM, sig. 672.

¹⁶ „Rilindja”, Prishtinë, 20 korrik 1947.

e burrave dhe ndikimin e rrethit, i cili në këtë kohë ishte përplot paragjykime të së kaluarës.¹⁷

Lëvizja e femrave të Kosovës për t'u çliruar nga çarçafi ishte hapi i parë drejt përparimit të tyre të gjithanshëm, që gjeti për-krahje te njerëzit përparimtarë, fshatarët, punëtorët, fetarët përparimtarë e sidomos te intellegjenca shqiptare. Me përpjekjet e veta të vazhdueshme për realizimin e këtij aksioni u dallua organizata e PKJ-së, e cila që në ditët e para të pasçlirimit i kushtoi kujdes të posaçëm luftës për emancipimin e femrës në përgjithësi, e në veçanti asaj shqiptare, për shkak të pozitës së saj specifike që kishte në shoqëri.¹⁸

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij aksioni, Komiteti Krahinor i PKS-së për Kosovë e Metohi bëri mbledhje më 8 maj 1947. Në këtë mbledhje, pos të tjerash, thuhet se për t'u realizuar me sukses aksioni për heqjen e çarçafit është më se e domosdoshme që të mos kufizohet vetëm tek anëtarët e Partisë dhe tek intelektualët dhe njerëzit përparimtarë, por të përfshihen masat e gjera popullore, në mënyrë që të mos i lejohet reaksionit të ketë ndikim në to. Duhet të merren masa dhe të gjenden forma të ndryshme pune në mënyrë që aksioni të shpejtohet — thuhet në vazhdim. Komiteti Shqiptar duhet të bëjë mbledhje të njëpasnjëshme në çdo mjedis të krahinës sonë në mënyrë që masave t'u sqarohet rëndësia e aksionit. Komunistët duhet të prijnë si shembull duke zbuluar femrat nga familjet e tyre. Këtij problemi duhet t'i kushtohet më tepër rëndësi në shtypin për gra dhe të punohet edhe më tepër në ngritjen e atyre femrave që hoqën çarçafin, në mënyrë që ato të bëhen propagatore të kësaj lëvizjeje.¹⁹

Masat që Partia merrte kundër të gjithëve atyre që me forma të ndryshme e pengonin përparimin e femrës, ishin mjaft rigorozë. Për këtë më së miri dëshmon fakti se në vitin 1948 u larguan nga radhët e Partisë 171 anëtarë për shkak se kundërshtuan heqjen e çarçafit për gratë dhe motrat e tyre.²⁰

Që në fillim këtë aksion u përpoqën në çdo mënyrë ta pengojnë elementët e ndryshëm reaksionarë, e sidomos kleri reaksionar mysliman, i cili, duke shfrytëzuar prapambetjen e masave të gjera popullore, pati ndikim të madh në to. Ruajtjen e zakonit të mbajtjes së çarçafit dhe të peçës u munduan ta paraqesin si gjë që mbron moralin mysliman, prandaj vazhdimisht mbronin edhe mendimin se femra myslimane shqiptare duhet ta mbajë patjetër këtë veshje. Qëllimi i tyre reaksionar ishte të pengonin që hiq më pak se gjysma e popullsisë të mos merrte pjesë në ndërtimin e shoqërisë së re socialiste. Me idetë dhe propagandën e tyre reaksionare u përpoqën ta pengonin femrën shqiptare, që edhe ajo, njësoj sikurse shoqet e tjera nëpër viset e tjera të Jugosllavisë, të bëhej faktor i rëndësishëm në jetën politiko-shoqërore dhe ekonomike.²¹

¹⁷ *Po aty*, 3 mars 1947.

¹⁸ „Buletin”, Prishtinë maj 1948.

¹⁹ AIHK, OKKM, sig. 689.

²⁰ AIHK, OKKM, sig. 676.

²¹ „Rilindja”, Prishtinë, 2 fror 1948, „Buletini”, Prishtinë nr 5. 6, 1947.

Mirëpo, duhet theksuar se që në fillim të aksionit kleri përparimtar mysliman u distancua nga ai reaksionar. Kështu, në maj të vitit 1947 Sekretariati Krahinor i Komitetit të Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë mori një letër të firmuar nga një grup fetarësh nga Gjakova, Peja, Istogu, Mitrovica, në të cilën thuhet: „Të dashur shokë, të nënshkruemit në lidhje me fushatën e heqjes së çarçafit, fushatë kjo e fillueme nga gratë antifashiste që kanë ngjallë një interesim të madh të gjithë muslimanët e vendit tonë, biseduam mes veti dhe mbasi ramë dakort vendosëm t'iu bajmë këtë propozim. Meqenëse elementët e ndryshëm reaksionarë dhe fanatikë duan ta paraqesin këtë fushatë si të papajtueshme për fenë islame si gja kundër Kuranit dhe ideve predikuese të Pajgamerit, është mirë që të mbledhet ylemaja nga të gjitha vendet në Krahinën tonë që ta shqyrtojnë këtë çështje, të çfaqë mendimin e vet mbi këtë problem kaq me rëndësi për popullin tonë”²²

Në bazë të kësaj letre, Sekretariati Krahinor i Komitetit të Shqiptarëve të Kosovës dhe të Metohisë u bëri thirrje të gjithë ylemave të Krahinës dhe më 27 maj 1947, në Prishtinë, u bë Konferenca I e Ylemave, ku morën pjesë 221 hoxhallarë e shehlerë. Në këtë konferencë morën pjesë edhe anëtarët e Sekretariatit të Komitetit të Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë në krye me shokun Fadil Hoxha dhe përfaqësuesit e Organizatës së FAG-ut. Pas një diskutimi të gjerë lidhur me heqjen e çarçafit e të peçës, Këshilli i zgjedhur paraqiti rezolutën që u nënshkrua nga 217 përfaqësues të fesë islame me katër vota kundër.²³

²² „Rilindja”, 22 maj 1947; „Buletini”, nr. 5, 6, Prishtinë 1947.

²³ „Buletini”, nr. 5—6, Prishtinë, 1947, (Meqenëse ky dokument është me rëndësi, po e japim në tërësi). 1) Aksioni i deritashëm për zbulimin e grave në Kosovë e Metohi ka dhënë rezultate të mëdha. Ai është mirëpritur ndër masat shqiptare e sidomos të shqiptarët. Prova me e mirë është fakti se në dy aksione, më 8 mars e Një Maj, numri i shqiptarëve të zbuluara ka arritur në 3000 veta dhe se në këto ditë në rrethin e Suharekës shumica e grave janë të zbuluara. Ne mendojmë se ky aksion dhe suksesi i tij është përfundimi i kuptimit të muslimanëve shqiptarë se ata sot, kur i kanë të gjitha kandidat e nevojshme për zhvillimin e tyre kulturor, ekonomik e politik, duke zbuluar gratë, nënat, motrat e veta, i heqin ato pengesa, që ndalin zhvillimin e përparimin e tyre në kohën e ardhshme. 2) Na kleri musliman, që duhet ta njohim më mirë fenë islame, mendojmë se zbulimi i muslimanëve shqiptarë nuk është kurrfarë akti i drejtueme kundra fesë islame, sepse islamizmi as nuk e kundërshton, përparimin. Prova ma e mirë është favor të kësaj theze asht e djepi i Islamizmit ka herë e ka zgjedhë çështjen e zbulimit të grues, që pengonte përparimin e saj n'ato vende. Na e dijmë se zbulimi i grave ka shpejtësue përparimin e popujve muslimanë, si bie fjala në Bashkimin Sovjetik, në Shqipëri e në vende të tjera myslimane. Na, po ashtu, e dijmë se para një gjysëm shekulli pjesa më e madhe e muslimanëve të Krahinës s'onë nuk ka pasë ferexhe, të cilën agresori na ka imponue për mbrijtjen e qëllimeve të veta të ndyeta. Për ne fetarët muslimanë të Kosovës e të Metohisë zbulimi i grave don me thanë vetëm mundësi që pjesa më e madhe e popujve t'onë, e cila deri tash asht mbajtë larg jetës shoqërore e kulturore të marri pjesë ne jetën e sotshme të vendit t'onë, aktivisht në ndërtimin e një t'ardhmes ma të mirë për vëdi dhe për femit e vet. Prandaj çdo thanje e tentativ që të na në Kosovë e Metohi të pengohet zbulimi i grave për çdo arsye qoft të, në realitet, don me thanë me pengue përparimin e popullit t'anë dhe t'atdheut t'onë RFPJ. Ata që me spjegime të ndryshme tentojnë me ndalë aksionin e zbulimin e grave nuk mund të paraqiten musli-

Gjatë viteve 1947—1949, aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës zgjoi interesim të madh të shumica e femrave shqiptare. Ato me anë të letrave herë të nënshkuara personalisht e herë kolektivisht, dhe shpeshherë anonime, shprehën dëshirën e flakët për heqjen sa më parë të kësaj veshje. Në një letër dërguar Komitetit Shqiptar, shkruar prej nja 10 femrave të Pejës thuhet: „Na nxuerët nga robëria shumëvjeçare e të huajit, çka pritni që nuk na nxirni nga robëria e çarçafit e na nxini jetën”.

Ndërsa, një e re kështu shkruan: „Adeti i kobshëm i çarçafit më ndau bash në lulen e verës sime nga klasa e dytë e gjimnazit. Fatim tim e kanë edhe shumë shoqet e mia që i kanë babat fanatikë si unë”.²⁴ Këso letrash protestuese kundër mbajtjes së çarçafit Komitetit Shqiptar dhe Organizatës së FAG-ut i arrinin pothuajse çdo ditë, ku të rejat përparimtare kërkonin nga organizatat e ndryshme shoqërore dhe politike, që aksioni të merte fund sa më parë. Kërkesat e shumta që vinin nga vetë të rejat përparimtare, para grave antifashiste shtruan çështjen në mënyrë edhe më serioze. Fushatat që u ndërmorën në shkurt të vitit 1947 zgjuan përkrahje të gjithanshme të forcave përparimtare. Ky aksion dha rezultate të dukshme. Kështu, më 8 mars e 1 maj po të këtij viti në mitingje e manifestime të organizuara për këtë rast,

man ma të denjë se muslimanët e atyne vendeve, të cilët janë djepi i Islami-zmit dhe që me kohë e kanë hjekë ferexhen. Muhamedi Alejhi-Se-lam e ka porosit të gjithë muslimanvet: „Kërkonti dijni kudo, në qoftë se e gjeni edhe në Kinë, jepni fëmijëve t'uej”. Tue u mbështetë tekstualisht me këto fjalë, na kërkojmë që grueja muslimane-shqiptare të zbulohet, që pjesa më e madhe e popullit t'onë të pajiset me dijeni e shkencë, që të naltësohet kulturisht dhe të krijojë për vehten e vet kandidatët për jetën ma të lumtun e ma të mirë. 3) Në mënyrë ma të singert e përpjekjeve të gjithanshme të të gjithë popujve t'onë për ndërtimin sa më të shpejtë të vendit t'onë, për lulizimin e tij ekonomik e kulturor dhe se ky aksion është për dobi të madhe në këtë drejtim. Kuptimi i gjanë i këtij aksioni nga të gjithë muslimanët përparimtarë të Krahinës s'onë asht prova ma e mirë e koshiençës së tyne të naltë patriotike dhe dashunis ndaj atdheut t'onë RFPJ. Fakti që ky aksion ka përfshi shtresat ma të gjana të masave ashtu merita e Komitetit Shqiptar, i cili me përpjekje të veta në popullarizimin e këtij aksioni përnji-mend plotson rolin e vet fisnik e të shenjtë të naltësimit dhe të zhvillimit të shqiptarëve në Krahinën tonë. 4) Thrasim të gjithë muslimanët e Kosovës dhe të Metohisë që pa asnji rezervë t'a pranojnë dhe t'a përkrahin këtë aksion. Dhe t'ue zbulue femnat e veta të diftojnë për sa asht e naltë te ata ndërgjegjia për interesat shtetërore dhe kombëtare dhe se në ç'shkaillë i dallojnë këto interesa nga zakonet e mykuna të jetës s'errët të së kaluarës. Thrasim të gjithë muslimanët e Krahinës s'onë që me vendosmëni t'u kundërshtojnë të gjitha spjegimeve jo të drejta të këtij aksionit, të cilat kanë për qëllim që këtë aksion t'a paraqesin si një kundërshtim me fenë islame dhe në këtë mënyrë t'a paraqesin popullit t'onë si aksion jo të drejtë. Kësi-soi spjegimesh janë në kundërshtim me interesat e shqiptarëve të Krahinës s'onë dhe nuk kanë kurrfarë justifikimi. 5) Tue u mështetë në faktin se roli i klerit të vërtetë populluer musliman qëndron bash në punën se tue i sher-byer besnikrisht fesë islame njëkohësisht i shërben sinqerisht edhe popullit, na thrasim edhe të gjithë ata fetarë muslimanë, të cilët nuk kanë marrë pjesë në këtë konferencë që ta pranojnë rezolucionin t'onë dhe ta përhapin gjithkund ku jetojnë muslimanët dhe të përpiqen për zbatimin e tij të plotë. Në këtë mënyrë na fetarët muslimanë — hoxhë dhe shehlerë — do ta lajmë borxhin t'onë ndaj atdheut dhe popullit dhe do ta kryejmë detyrën tonë përparimin dhe ardhëmënin ma të lumtur.

²⁴ „Rilindja”, 6 gusht 1947.

më të guximshmet dhe më përparimtare, që e kuptuan rëndësinë e çlirimit nga çarçafi, në mënyrë protestuese dhe publikisht e hodhën poshtë çarçafin në shumë mjedise të Krahinës sonë dhe u bënë thirrje femrave të tjera që të vepronin si ato. Në këtë fushatë u dalluan femrat e Suharekës dhe, sipas të dhënave, gjatë kësaj kohe, në këtë mjedis u zbuluan 1100 veta.²⁵

Në mbarë Krahinën gjatë vitit 1947 çarçafin e hoqën 25.000 — 30.000 femra shqiptare.²⁶

Femrat shqiptare nga Kosova në vitin 1947 nëpër tubimet e tyre kërkuan që Qeveria e RP të Serbisë të nxirte ligjin mbi ndalimin e çarçafit dhe të peçës. Kuvendi Popullor i RP të Serbisë nxori Rezolutën në të cilën përkrahu kërkesën e femrave përparimtare nga Kosova.²⁷

Por, pos të gjitha rezultateve që u arritën gjatë viteve 1947—1950, një pjesë bukur e madhe e femrave shqiptare ende ishin nën çarçaf. Një dukuri e këtillë e pengonte mjaft punën në mesin e grave shqiptare si dhe forcimin dhe masivizimin e organizatës së tyre. Për shkak të dobësive që pati aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës gjatë vitit 1948, siç kemi thënë më parë, në këtë periudhë, duke rënë sërish nën ndikimin e reaksionit prej, 5473 femrave, sa u zbuluan gjatë këtij vitit, 4296 përsëri e veshën çarçafin.²⁸

Aksioni më i thelluar për zhdukjen e peçës e të çarçafit gjeti efekt pozitiv me fillimin, edhe pse të pjesërishëm, të inkuadrimit të femrave në degët e ndryshme të ekonomisë. Për femrat e inkuadruara, të cilat ranë nën ndikimin e sërishëm të reaksionit dhe u mbuluan, u morën masa përkatëse. Kështu, gjatë vitit 1949 në sipërmarrjen e artizanateve për femra në Prizren u larguan nga puna të gjitha ato që përsëri e veshën çarçafin.²⁹

Luftën për heqjen e çarçafit, komunistët dhe forcat përparimtare e kishin filluar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ndërsa në përmasa më të mëdha, në periudhën e rindërtimit dhe të ndërtimit socialist në Kosovë. Një numër i grave, të cilat në mënyrë të vetëdijshme qëruan mendimet me prapambetjen shekullore, hoqën çarçafin dhe u bënë pjesëmarrëse aktive në jetën politiko-shoqërore. Mirëpo, çlirimi i vendit pjesën më të madhe të grave e gjeti në pozitë të shtypur shoqërore. Kështu që mbajtja e çarçafit dhe e peçës në kushte të reja të zhvillimit ishte bërë pengesë për zhvillimin e plotë ekonomik, politik e kulturor të krahinës sonë. Ky zhvillim do të ishte edhe më i shpejtë nëse në të dc të merrte pjesë edhe femra në mënyrë të barabartë me meshkujt, siç ishte e garantuar në nenin 24 të Kushtetutës së RFPJ-së.³⁰

²⁵ AIHK, OKKM, sig. 642.

²⁶ AIHK, OKKM, sig. 690, dok. 2630.

²⁷ AK AFZ K/1 *Izveštaj Izvršnog odbora Antifašističkog Fronta žena Jugoslavije na Trećem Kongresu AFŽ Jugoslavije, o dostignućima i ulozi žena i o radu AFŽ u izgradnji socijalizma od II do III Kongresa AFŽ, Zagreb, 23—29, oktobar, 1953.*

²⁸ AK. AFŽ. K/1

²⁹ *Polity, K. 2.*

³⁰ Neda Božinović i Dr. Maks Šnuder, *Položaj žena u FNRJ, Beograd, 1953, 9; „Rilindja” 1 kallnor 1951.*

Lufta kundër zhdukjes së çarçafit dhe të peçës nuk ishte aksion i rastit, i cili mund të kryhej në mënyrë administrative, po një domosdoshmëri historike që diktohej nga nevoja për formimin e njeriut të ri. Së këndejmi, lufta për zhdukjen e çarçafit dhe të peçës kërkonte inkuadrim dhe angazhim të gjithanshëm të të gjitha subjekteve të organizuara dhe forcave përparimtare, luftë kjo që duhej të zhvillohej në mënyrë të vazhdueshme deri në çlirimin e vërtetë të femrës, si subjekt i rëndësishëm shoqëror politik dhe kulturor në shoqërinë socialiste.

Lëvizja për heqjen e çarçafit dhe të peçës vazhdoi në mënyrë më të organizuar dhe dha rezultate më të mëdha gjatë viteve 1950 — 1951. Kjo çështje u vu si një nga detyrat kryesore të Frontit Popullor, Komitetet Nacionale të Shqiptarëve dhe të forcave të tjera të organizuara politiko-shoqërore, të cilat luajtën rol të rëndësishëm në realizimin e aksionit. Nëpër rrethe u bënë mbledhjet e Komitetit të Shqiptarëve, ku morën pjesë një numër i mirë aktivistësh më autoritativë, që kishin ndikim në masa dhe përfaqësuesit e fesë islame. U shfrytëzuan forma të ndryshme të punës — takime me grupe të vogla njerëzish, u organizuan ligjërata të ndryshme lidhur me rëndësinë e heqjes së çarçafit dhe të peçës. Ligjëratat u organizuan pothuajse në çdo fshat të Krahinës. U sqarua se çfarë pengese është mbajtja e mëtutjeshme e çarçafit dhe e peçës për zhvillimin dhe ngritjen kulturore e arsimore të femrës sonë, e bashkë me të edhe të vetë kombit.³¹

Edhe pse lufta për zhdukjen e peçës dhe të çarçafit në fazën e dytë kishte marrë përpjesëtime më të gjera, reaksioni në mënyrë përfide përpiquej ta pengonte aksionin duke përhapur parulla të ndryshme, siç ishin: „Pas heqjes së çarçafit do të vijë ligji edhe për heqjen e plisave” (në rrethin e Llapit”). Ndërsa nga ana e reaksionit serb përhapeshin parulla „se shqiptarët i kanë shikuar mjaft femrat serbe të zbuluara, radha është që edhe ata t'i shohin femrat shqiptare pa çarçaf”. Parullat e tilla armiqësore u dënuan rrept nga ana e pushtetit popullor. Kështu, në rrethin e Sitnicës dhe të Vuçiternës për propagandë të tillë armiqësore u burgosën disa veta.³²

Ardhja në Kosovë e zëvendësit të Reisul Ylemas, Haxhi Murat Sheqiragiqit ndikoi që ky aksion të shpejtohet, sepse në mbledhjet që u bënë në qytetet e ndryshme të Krahinës si në Prishtinë, Mitrovicë e gjetiu, iu sqarua masave të gjera popullore rëndësia e heqjes së çarçafit dhe të peçës. Ai në bazë të doktrinës fetare arsyetoi se mbajtja e peçës dhe e çarçafit të femrat myslimane nuk ishte zakoni fetar. Problemin e arsyetoi duke dhënë shembuj nga vendet ku jetonin myslimanët ku çarçafi nuk ekzistonte fare. Me që femrat myslimane të Bosnjës e të Hercegovinës dhe të Maqedonisë, në pjesë më të madhe e kishin hequr çarçafin, ishte më se e domosdoshme që rrugën e tyre ta ndienin edhe femrat shqiptare. Kështu, në shumë mjedise të Krahinës gratë filluan të dilnin

³¹ AK, AFŽ, K/1, K/4, K/6; „Rilindja”, 18, 21 kallnor 1951.

³² AK, AFŽ, K/4, raport mbi aksionin për heqjen e çarçafit dhe të peçës.

pa çarçaf: në Mitrovicë e hoqën 200 gra, në fshatrat Shurdhan, Cërnica e Prilepnicë u bënë meetingje, ku 400 femra dolën pa çarçaf. Rezultate të mira ky aksion i arriti në Ferizaj, Gjilan, Kaçanik, Elez Han etj. Kishte raste kur brenda ditës gratë në një numër bukur të dukshëm hidhnin demonstrativisht çarçafin si: në Viti, Gjakovë, Prizren, Pejë etj. Ndërsa, në ato rrethe, ku puna me gra ishte e dobët, si në rrethin e Moravës së Epërme, Istogut, Graçanicës dhe Vuçitërnës aksioni stagnonte. Në këto mjedise, të rralla ishin femrat që e kishin hequr çarçafin.³³

Para se të hynte në fuqi Ligji mbi ndalimin e peçës e të çarçafit, numri i femrave që e kishin hequr çarçafin në Krahinë përafërsisht arrinte: në rrethin e Ferizajt 13.000 veta, të Vitisë 3.500, të Pejës 2.500. Sipas të dhënave të kësaj periudhe çarçafi në këto mjedise pothuajse ishte zhdukur. Kështu, çarçafin e hoqën në këtë kohë në Prishtinë 1.420 femra, Podujevë 2.100, Vuçitërnë 1.270, Mitrovicë të Titos 626, Serbicë 1.815, Gjakovë 7.300, Suharekë, 3.186, Rahovec 6.150, Prizren 5.100, Dragash 4.592, Lipjan 6.00, Gjilan 2.992, Kamenicë 5.893, në Mitrovicë 2.152. Sipas të dhënave, para se të hynte në fuqi Ligji mbi ndalimin e peçës dhe të çarçafit në Krahinë, çarçafin e hoqën gjithsej 79.661 veta.³⁴ Ky ishte aktiviteti i madh politik që zhvilluan organizatat politiko-shoqërore dhe luftuan, njëkohësisht, çdo tendencë të reaksionit, i cili donte të pengonte zbatimin e Ligjit.

Aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës gjatë vitit 1951 kishte marrë hov të madh. Në konferencat e shumta që mbaheshin në të gjitha lagjet e qyteteve, shumë gra e vajza më të guximshme vinin pa çarçaf. Shembuj të mirë për realizimin e aksionit treguan përfaqësuesit e klerit mysliman të qytetit të Pejës, të cilët, ndër të parët ua hoqën çarçafin grave të veta dhe ndikuan te të tjerët për një punë të tillë. Për një aktivitet të tillë u dalluan gratë e bllokut të 17-të të Pejës, të cilat u shpallën gara të gjitha blloqeve të tjera se kush do ta flakte më parë çarçafin në terrenin e tyre. Aktivistët kërkuan nga përfaqësuesit e pushtetit popullor që të ndalej dalja e grave me çarçaf në rrugë edhe para nxjerrjes së Ligjit.³⁵ Edhe në Prishtinë për likuidimin e çarçafit para nxjerrjes së Ligjit, u bë një aksion i përgjithshëm popullor. Në konferencat e Organizatave Themelore të Frontit pjesëmarrësit nuk hehshnin si përpara kur bëhej fjalë për zbatimin e aksionit. Në bazë të aktivitetit që kishin bërë organizatat politiko-shoqërore shumica e qytetarëve e kuptoi rëndësinë e aksionit, siç shihet nga zotimet që jipeshin nga pjesëmarrësit se në radhët e familjeve të tyre do ta flaknin çarçafin, ndërsa, ata të cilët ishin pasivë dhe përiqeshin në forma të ndryshme t'i bishtëronin aksionit, demaskoheshin dhe përjashtoheshin nga Fronti Popullor.

Në luftën kundër çarçafit në këtë kohë u dallua kolektivi i sipërmarrjes „Milladin Popoviq” në Prishtinë. Në krye të këtij ak-

³³ Si shën. 32; „Buletini” nr. 3, Prishtinë, 1951; „Rilindja”, nr. 15. Prishtinë 1951.

³⁴ Po aty.

³⁵ Si shën. 33.

sioni ishin vetë punëtorët, të cilat me veprimtarinë e tyre ndikuan te një pjesë e mirë e femrave shqiptare, duke dhanë sqarime lidhur me rëndësinë e zhdukjes të kësaj veshjeje nënçmuese për femrën. Në të njëjtën kohë ato agjituan që femra të pavarësohet ekonomikisht dhe të inkuadrohet në degët e ndryshme të ekonomisë.³⁶

Organizatat Themelore të Frontit bënë luftë sistematike kundër mbajtjes së çarçafit dhe pothuajse në çdo mbledhje aktivistët ia arrinin qëllimit t'i bindnin masat për rëndësinë e heqjes së çarçafit. Kështu, për shembull, në një konferencë të Organizatës Themelore të Frontit në Mitrovicë, çarçafin e hoqën afër 200 gra shqiptare. Këtij aksioni iu bashkuan edhe organizatat sindikale, të cilat, me aktivitetin e tyre ia arritën qëllimit që të ndikojnë te punëtorët, që në familjet e tyre t'u ndalonin grave mbajtjen e kësaj veshjeje.³⁷ Po ashtu, rezultate të mira para nxjerrjes së Ligjit, në flakjen e çarçafit, u arritën edhe në Prizren, ku ndihmuan majft edhe përfaqësuesit përparimtarë të klerit.³⁸

Aksioni për zhdukjen e çarçafit kishte marrë përpjesëtime të gjera edhe në Gjilan, sidomos pas formimit të grupeve agjituase në qytet dhe në fshat. Në sajë të punës së mirë të këtyre grupeve, për një kohë shumë të shkurtër, në shumë fshatra, gratë filluan ta hiqnin çarçafin. Kështu, në këtë qytet brenda një dite më se 300 gra u liruan nga çarçafi. Në këtë aktivitet u dalluan Sektori i Tretë i qytetit, gratë e të cilit gati qind për qind hoqën çarçafin, përpos 7 shtëpive. Sipas të dhënave, në fshatin Cërnice u zbuluan 160 gra, ndërsa në fshatrat Zhegër e Shurdhan shumica e grave nuk e bartnin më. Në Pozharan anëtarët e Frontit Popullor me një telegram që i dërgojnë në shkurt të vitit 1951 Këshillit Popullor Krahinor thonë se jo vetëm në mjedisin e tyre çarçafin do ta zhdukin, por nuk do të lejojnë asnjë grua nga fshatrat e tjera të hyjnë në Pozharan me çarçaf.³⁹

Të gjitha mjediset e krahinës sonë në këtë kohë i dallon një aktivitet i madh lidhur me zbatimin e aksionit për flakjen e çarçafit dhe të peçës. Madje, duke përfshirë edhe ato mjedise ku rezistenca ishte e dukshme. Kështu, gratë e fshatit Stanovc të Poshhtëm në rrethin e Vuçitërnës, pas një meetingu, pothuajse të gjitha e flakën çarçafin.⁴⁰

Me gjithë aktivitetin që zhvilluan forcat progresive në këtë kohë në Kosovë, çarçafi nuk u zhduk krejtësisht, për shkak të mentalitetit prapanik dhe botëkuptimeve patriarkale që kishin zënë rrënjë të thella në mendjen e njerëzve dhe paragjyqimeve përkitazi me aftësitë e femrës në përgjithësi. Por duhet theksuar se dobësit u manifestuan për mungesë të masivizimit të kësaj lëvizjeje që t'i përfshinte shtresat fshatare e punëtoresh dhe t'i vinte

³⁶ *Po aty.*

³⁷ *Po aty.*

³⁸ *Po aty.*

³⁹ *Po aty.*

⁴⁰ *Po aty.*

ato në krye të lëvizjes. Aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës u kuptua edhe si gjë e përkohshme e jo si luftë permanente deri në realizimin e plotë të saj.

Duke i lënë masat të vepronin në mënyrë stihike dhe aksioni të kuptohej si i përkohshëm, nuk u mbyll rruga e botëkuptimeve të ndryshme, të cilat vepronin në masa. Fakti se më tepër se gjysma e femrave mbanin ende këtë veshje dëshmonte se në radhët e qytetarëve ende ishin të fortë elementët që nuk e kishin kuptuar rëndësinë e këtij aksioni. Përpos kësaj, kishte edhe të atillë që nuk donin ta kuptonin një gjë të tillë, sepse nuk ua donte interesi i tyre. Këta elementë rridhnin nga sintresat borgjeze, bejlerët, agallarët, tregtarët dhe kleri reaksionar. Prandaj, që të mos bien në pozitë e reaksionit, u lind nevoja e luftës së rreptë kundër mendimeve reaksionare lidhur me gruan dhe aksionin për heqjen e çarçafit dhe të peçës.⁴¹

Lëvizja për zhdukjen e çarçafit dhe të peçës merr përpjesëtime të gjera në vitin 1951, e sidomos pas kërkesës që i bëri Këshilli Krahinor i Kosovës e Metohisë Kuvendit Popullor të RPS për nxjerrjen e Ligjit, me anë të të cilit duhej të ndalohej bartja e çarçafit. Në bazë të kësaj kërkesë dhe shumë të tjerave, që dërgoheshin nga organizatat e ndryshme dhe individë, më 25 mars të vitit 1951, nxirret Ligji mbi ndalimin e mbajtjes së peçës dhe të çarçafit.⁴²

Ligji mbi ndalimin e peçës dhe të çarçafit ishte një masë revolucionare e pushtetit popullor në interesat e barazisë e të drejtave të femrës, i cili do t'i hapë rrugët e emancipimit të saj në të gjitha fushat e jetës.⁴³

Me Ligj parashihej jo vetëm ndalimi i mbajtjes së çarçafit dhe të peçës, por edhe çdo formë tjetër e mbulimit të fytyrës. Me Ligj parashihnin edhe masat ndëshkimore kundër të gjithë atyre që i shkelnin dispozitat e këtij ligji: kushdo që veshte çarçafin e peçën dhe e mbulonte fytyrën, si dhe kushdo që kërkonte prej pjesëtarëve të familjes një gjë të tillë do të dënohej deri me 2 muaj burgim ose me të holla deri në 20.000 dinarë. Kushdo që përpiqej me forcë ose me kërcënime që të vishej çarçafi e peçja, gjithashtu kush bënte propagandë për mbajtjen e çarçafit do të dënohej me 2 vjet burgim ose me 50.000 dinarë.⁴⁴

Ky Ligj u nxor si rezultat i lëvizjes së gjerë të grave përparimtare për heqjen e çarçafit dhe të peçës, në kohën kur te një shtresë e grave ishte ngritur vetëdija se çarçafi ishte njëra ndër pengesat kryesore për emancipimin e tyre. Mirëpo, ky Ligj në Krahinën tonë nuk erdhi si pasojë e ngritjes së vetëdijes së masës, por si masë e domosdoshme për emancipimin e femrës.

Pas nxjerrjes së Ligjit për ndalimin e peçës dhe të çarçafit një numër bukur i mirë i grave e kundërshtuan në forma të ndryshme. Ato filluan të dilnin natën ose në një mënyrë të mbanin

⁴¹ „Rilindja”, 6 gusht 1947.

⁴² AK, AFZ, K/6, „Rilindja” 18 janar, 15 mars 1951.

⁴³ „Rilindja”, 9 mars 1951.

⁴⁴ „Rilindja”, 25 kallnor 1951.

fytyrën e mbuluar me shami dhe pjesën e poshtme të çarçafit. Kishte raste kur ato haptazi kundërshtuan Ligjin duke mbajtur çarçafin nëpër rrugë.⁴⁵

Në realizimin e këtij aksioni ishte dukuri pothuajse e përgjithshme se agjitacioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës më me sukses zhvillohej në ato vise, ku më me suksese zbatoheshin edhe masat e tjera. Format e agjitacionit pothuajse në çdo mjedis u nënshtroheshin kushteve specifike të atij rrethi. Në shumë mjedise ajo në fillim humbi intensitetin dhe vendosmërinë, të cilën e shfrytëzoi armiku. Aty ku në masë të konsiderueshme u angazhuan organizatat partikae dhe të Frontit (sidomos Komitetit Shqiptar në kuadër të Frontit), ku aktivet vepronin më me vendosmëri, aty sukcesi ishte më i madh. Kështu, p.sh., në Prizren, Gjakovë dhe në Pejë Ligji për heqjen e çarçafit dhe të peçës u prit mirë, madje, edhe me kënaqësi, gjë që dëshmon se kërkesat për heqjen e çarçafit erdhën nga vetë masat. Ndërsa në shumë mjedise të Kosovës, si në Ferizaj, Pejë, lidhur me heqjen e çarçafit dhe të peçës u diskutua edhe në shoqatat sindikale. Ndërsa nëpër fshatra, si në Junik, fshatarët nxorrën edhe „Ligjin e tyre të pashkruar” që në fshatin e tyre të mos hynte as një femër nga fshatrat e tjera me çarçaf.

Në shumë mjedise të Kosovës, ku aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës nuk zhvillohej ashtu si duhej, ky Ligj hasi në kundërshtim, meqë ndikimi i elementëve armiqësorë ende ishte i pranishëm.⁴⁶

Kështu, në prag të nxjerrjes së Ligjit, pozitat dhe tentativat e reaksionit që ta pengonin heqjen e çarçafit, ishin kundërvënien politike, jo vetëm kundër aksionit për heqjen e çarçafit, por edhe kundër zhvillimit të shoqërisë së re socialiste dhe progresit në përgjithësi. Rezistenca ishte më e thellë. Ajo orientohej, edhe pse jo haptazi, kundër politikës së Partisë Komuniste, forcave të organizuara progresive dhe sistemit në përgjithësi. Ata, duke shfrytëzuar dobësitë e aksionit, të cilat e shoqëronin, sidomos në agjitacionin dhe shpjegimin e ligjit, në mënyrë të ndryshme dhe parulla armiqësore ndikonin tek ata të cilët aksioni dhe Ligji futnin shqetësime dhe impononin luhatjet e tyre. Duke mos qenë në gjendjen që haptazi të argumentonin se „Ligji nuk sjell përparim arsimor, shëndetësor, ekonomik etj” — ata si armë të tyre përdornin fenë dhe shovinizmin kombëtar. Reaksioni shqiptar deklarohet se feja është në rrezik dhe se „as në shtëpi nuk janë të lirë”, kurse ai serb ngacmonte „Ja, ishte edhe mbreti dhe kështu nuk vepronte me ju”. Krejt kjo kishte një qëllim: duke shfrytëzuar dobësitë e aksionit e sidomos të qytetarëve të luhatshëm e të mashtruar, reaksioni merr si mjet propagandistik të veten prapambetjen dhe fenë, duke shkelur madje edhe të drejtat e shqiptarëve, vetëm e vetëm që të minohej, nëse është e mundur, bashkimi dhe vëllazërimi i kombeve dhe i kombësive në Kosovë.⁴⁷

⁴⁵ AK, AFŽ, K/1.

⁴⁶ AIHK, OKKM, nr. dok. 17981.

⁴⁷ „Politika”, 7 fror 1951.

Kështu, në prag të nxjerrjes së Ligjit u zhvillua një aktivitet i madh propagandistik dhe agjitues. Në sajë të aktivitetit të gjerë të organizatave, Frontit Popullor, FAG-ut, Sindikatave, të Bashkimit të Luftëtarëve dhe të Rinisë Popullore u arritën rezultate të mira. Në këtë kohë në Krahinë më se 90% të femrave hoqën çarçafin dhe peçen. Në ditën e votimeve për Kuvendin Popullor të Serbisë, më 18 mars të vitit 1951 femrat në pjesën më të madhe dolën pa çarçaf. Po ashtu edhe në meetingje, të cilat u bëne në shumë qytete me rastin e 8 marsit të këtij viti, gratë dolën pa çarçaf.⁴⁸ Disa të reja, të cilat deri dje ishin të mbyllura, së bashku me të rinjtë e Krahinës morën pjesë në ndërtimin e hekurudhës Dobojë-Banjallukë.⁴⁹

Pas nxjerrjes së Ligjit për heqjen e çarçafit dhe të peçës, në çdo rreth dhe qytet u zhvillua aktivitet i gjallë. Në çdo organizatë të Frontit Popullor u shpjegua rëndësia e këtij Ligji. Lidhur me zhvillimin e aksionit të përmendur në këtë kohë, duhet të veçohet aktiviteti i Organizatës së Rinisë Popullore në zbulimin e të reja-ve shqiptare. Kështu, vetëm në prag të nxjerrjes së Ligjit në fillim të marsit të vitit 1951, përveç suksesit të madh të arritur në Gjakovë, Organizata e Rinisë Popullore ia doli të zbulonte 220 të reja në rrethin e Serbicës, 45 në Mitrovicë, 120 në Dragash, 60 në Vuçitërnë, 37 në Gjilan, 60 në Rahovec, 70 në Podujevë dhe 50 në rrethin e Gjurakovcit.⁵⁰

Për t'u realizuar aksioni me sukses, pushteti popullor, në këtë periudhë, si dhe forcat e organizuara shoqërore politike, përdorën çdo formë jo vetëm të agjitacionit, por edhe ato që do të thyenin bindjen e njerëzve, duke krijuar kushte dhe mundësi që çështja e zbulimit të gruas të realizohej në mënyrë definitive.

Gjatë këtij aksioni iu shpërndan 88.700 triska industriale atyre grave, të cilat e kishin flakur këtë veshje para se të hynte në fuqi Ligji. Këto triska kapnin vlerën 82.048.500 dinarë. Nëpër të gjitha viset e Krahinës u hapën dyqane të posaçme të tekstilit, duke i furnizuar, në këtë rast, vetëm ato që kishin hequr çarçafin dhe peçen.⁵¹

Aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës gjatë vitit 1951 nuk u zhvillua vetëm në aspektin politik, por u shndërrua në një aksion të përgjithshëm masiv, duke u përcjellë me manifestime të ndryshme kulturore, të cilat, në radhë të parë, kishin në programin e tyre temën e heqjes së çarçafit dhe të peçës. Shoqëritë e ndryshme kulturo-artistike përgatitnin dhe shfaqnin programe, të cilat bënin jehonë dhe ndikim bukur të mirë në masat e grave. Nuk janë të rralla rastet kur pas shfaqjeve dhe dhjetra gra dilnin pa çarçaf dhe peçe. Në këto manifestime kulturo-artistike merrnin pjesë edhe burrat dhe aktivistët shoqërorë-politikë dhe personalitetet nga mjediset e tjera, siç ishin edhe përfaqësuesit autoritativë fetarë të vendit. Bie fjala, në Pejë shoqëria kulturo-

⁴⁸ „Rilindja”, 18 mars 1951.

⁴⁹ „Rilindja”, 11 fror 1951.

⁵⁰ „Rilindja”, 8 shkurt 1951.

⁵¹ „Rilindja”, 29 mars 1951.

artistike „Përparimi” në kuadër të inkuadrimit të vet në aktivitetin për heqjen e çarçafit dhe të peçës përgatiti dhe shfaqti pjesë teatrore „Çarçafi”, të cilën e shikuan një numër i madh grash dhe burrash.⁵²

Ky aktivitet kulturo-artistik u zhvillua në shumë mjedise: Mitrovicë, Gjakovë, Prizren, Gjilan etj. dhe në forma të ndryshme garash në shkallë të komunave dhe të rretheve. Pjesëmarrja e femrave në sajimin dhe në interpretimin e programeve të këtilla të angazhuara ishte mjaft e madhe.⁵³

Krahas aktivitetit manifestiv masiv kulturor dhe artistik, në fushatë u inkuadruan dhe zhvilluan aktivitete edhe krijues letrarë, piktorë, kompozitorë dhe punëtorë të tjerë publikë dhe kulturorë.

Kështu, në shtyp u botuan një sërë poezish, tregimesh, skeqesh, pikturash, të cilat u bënë pjesë përbërëse e aksionit të heqjes së çarçafit dhe të peçës, sidomosdo për përparimin e femrës në kushte të reja shoqërore. Krijuesit artistikë frymëzimet e veta i gjetën në të kaluarën e errët, duke ngritur zërin kundër saj dhe duke treguar rrugën e vërtetë të lirisë së gruas, barazinë dhe përpjekjet që duhet realizuar ajo në çlirimin e saj të plotë se „e robënueme e shkëlueme të shkante jeta në mjerim”, kurse „jeta e saj ishte kudo terr”⁵⁴ nga shkaku se „Femër! llomi i shekujve është grumbulluar në rrugën tënde...” Pastaj frymëzimi i poetit i bën kritikë zakoneve të stërgjysheve, të cilat qenë të egra ndaj saj se „çarçafi si i tillë është pengesë e çdo përparimi, fatkeqësi për çdo popull, pra edhe për mbarë njerëzimin”, sepse ai „është kulm i padrejtësive që janë bërë gjatë shekujve, si është më i madh poshtërim për një krijesë të gjallë, për njeriun”.⁵⁵

Duke ndier inkuadrimin e vet në luftën për heqjen e peçës dhe të çarçafit jo vetëm si detyrë të kohës, por si ndjenjë të vërtetë të krijuesit, poeti, duke e shfrytëzuar femrën për perspektivat që i hapen në shoqërinë socialiste, e fton që të jetë pjesëmarrëse aktive në jetën e re që ajo, e cila me shekuj „shkryhesh mbi prangat e lidhura nyneq” dhe të luftojnë për „Botën e re, të drejtat të gëzojë, vendi me ty përpara të shkoj”.⁵⁶

Përveç në poezi, u shkruan edhe shumë proza dhe skeçe dramatike nga jeta e përgjithshme, ku thumbohet në mënyrë të pakompromis çdo pengesë që i kundërvihet aksionit për heqjen e çarçafit dhe të peçës, ku temë trajtimi është konflikti ndërmjet jetës së re dhe botëkuptimeve reaksionare dhe prapanike.⁵⁷

Kjo fushatë, e cila gjeti vend meritore edhe në art në krijimtari, karakterizohet edhe nga fakti se pikërisht mu në këtë kohë filluan, sidomos në letërsi, të shkruajnë edhe femrat shqiptare. Të preokupuara për fatin e femrës në përgjithësi, edhe pse num-

⁵² Hasan Vokshi, *Çarçafi*, „Jeta e Re” nr. 4, 1950, 249—259.

⁵³ „Jeta e Re”, nr. 1, 1949, 321; *Po aty*, nr. 3, 1950, nr. 4. 150.

⁵⁴ Din Mehmeti, *Të resë sanë*, „Jeta e Re”, nr. 1. 1949.

⁵⁵ S. Nokshiq, *Çarçafi — pengesë e përparimit*, „Jeta e re” nr. 4, 1950.

⁵⁶ Enver Gjergjeku, *Femrës së mbyllur*, „Jeta e Re”, nr. 1, 2. 1950, 97—98.

⁵⁷ „Jeta e Re”, nr. 4, 1950, 256—259.

ri i tyre ishte i vogël, shkruan vargjet e veta, pothuajse të parat, pikërisht për problemin e heqjes së çarçafit dhe të peçës, vargje këto, ndonëse për nga vlera letrare janë të nivelit kryesisht aktual, karakterizohen si vlera që përshkohen prej ndjenjave të thella njerëzore, të përjetuara thellë në kohë e në relacionet kohore, me njomësi, sinqeritet, por edhe revoltë edhe revolucionaritet. Poetja, e vetëdijshme për kohën e re, duke kujtuar të kaluarën, përkatësisht pozitën e saj të derisakohshme që „Shekuj të tanë kanë fshajtë” dhe „mik gjithmonë m’ka qenë idhnimi”, kur mendon se lindi për te „Pranvera”, — „Shpresa” — mendon se „Shqiptaren e mjerë si përherë kurrkush ma s’do ta urdhënojë”, — duke parë lirinë dhe qenësinë e saj njerëzore në kushte të reja, ku „sot i madh e i vogël punojnë në çdo kand të vendit tonë”, e sheh veten dhe bashkëkohaniket e saj se „ende rrinë në një anë”, u drejtohet atyre me pyetje të thella njerëzore „na shqiptare ç’rijmë sepse koha s’po pret”. Andaj i thërret me revoltë që të bëhen pjesëtare aktive të jetës së re, të jetës së tyre njerëzore, të barabarta dhe të lira që „të flakin çarçafin e mallkuem e mbrapambetjen shekullore” që „të punojmë, të mësojmë e të naltësohemi — jetën e re ta gëzojmë”.⁵⁸

Vetëdija për përparimin te femra shqiptare tani na bëhet jo vetëm kërkesë e kohës, por edhe imperativ dhe e vetmja rrugë për qenien e lirë të saj njerëzore, sepse „Partia jonë me gjak hero i të rënë e themeloi, se femrat e reja të kësaj kohe në kushtet e reja shoqërore njerëzore duhet „Kah përparimi shpejtas të shkojmë — të drejtat dhe ne t’i gëzojmë”⁵⁹ — mendojnë ato.

Edhe artet e tjera — piktura, muzika e teatri dhanë kontribut të konsiderueshëm në realizimin e aksionit të FAG-ut dhe të forcave të tjera të organizuara. Edhe pse këto krijimtari artistike në kohën kur zhvillohej aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës ishin po ashtu në hapat e parë të zhvillimit, e shprehën tërë këtë aktivitet në mënyrë dinjitoze duke i dhënë jo vetëm përmbajtjen, por edhe peshën dhe vlerën historike.

Kështu, krijimtaria artistike pothuajse në tërësi u bë edhe faktor i pazëvendësueshëm krahas temave të tjera të kohës, i punës në ngritjen e vetëdijes dhe në propagandimin e aktivitetit të gjithmbarshëm të rëndësishëm të kësaj periudhe të zhvillimit socialist të Kosovës, duke i dhënë kështu, për dallim nga mjediset e tjera të vendit, vulën specifike të kohës.

Si shihet prej kësaj që u tha më lart, Ligji mbi ndalimin e peçës dhe të çarçafit nuk i zgjodhi të gjitha problemet komplekse të gruas. Gjithsesi heqja e kësaj veshje ia bëri të mundshëm femrës shqiptare që të inkuadrohej në jetën e përditshme politiko-shoqërore. Me heqjen e çarçafit pozita e femrës në esencë nuk ndryshoi shumë përderisa nuk u ngrit vetëdija e saj dhe nuk ndryshuan botëkuptimet për jetën. Ajo mbeti në shtëpi pothuajse në nivelin e mëparshëm. Edhe pas ndryshimeve të mëdha që iu bënë

⁵⁸ „Jeta e Re”, nr. 2, 1949, 181—188.

⁵⁹ „Jeta e Re”, nr. 1—2, 1950, 111.

pozitës së saj pas Revolucionit, me nivelin arsimor e kulturor që kishte femra shqiptare në Kosovë, nuk qe në gjendje t'i kuptojë menjëherë të gjitha ndryshimet që u bënë në shoqëri.⁶⁰

Mirëpo, rol të rëndësishëm në transformimin shoqëror dhe politik të femrës nëpërmjet formave të organizuara të punës, në heqjen e çarçafit, në aktivizimin e gruas në jetën shoqërore dhe politike, në ngritjen arsimore e kulturore, pas çlirimit luajti edhe FAG-u në Kosovë, si pjesë e forcave të organizuara shoqërore-politike.

Dr. Drita Bakia — Gunga

L'ENLÈVEMENT DU TCHARTCHAF ET DE LA VOILETTE EN KOSOVÉ

R é s u m é

Une des formes de déni des droits humains élémentaires de la libération de la femme, était le contrainte du port du tchartchaf (de la mante) et de la voilette. Cette coutume s'était imposée particulièrement pendant la domination ottomane, tandisqu'au temps de la Yougoslavie bourgeoise fut appuyée comme forme de repression envers la femme de la part du régime antipopulaire.

La lutte pour le rejet du tchartchaf et de la voilette était une nécessité progressives ont entamé depuis la lutte nationale libérale, tandisqu'à des grandes dimensions dans la période de l'edification et réedification socialistes.

La lutte pour le rejet du tchartchaf et de la voilette était une nécessité historique dictée par le besoin à la formation de nouvel homme.

Le mouvement des femmes de la Kosovë pour se libérer du tchartchaf fut un pas vers le progrès entier et trouva le soutien par les hommes progressifs: paysans, ouvriers, cleric progressif et surtout par l'intelligence albanaise. Tous les milieux de notre province furent preoccupés faisant une grande activité à l'application de l'action dans l'enlèvement du tchartchaf et de la voilette.

Malgré l'activité développée par les forces progressives à cette époque — là, en Kosovë, le tchartchaf ne fut pas rejeté entièrement, c'est à cause d'une mentalité retrograde et des conceptions patriarcales des gens et des préjugés présents dans l'aptitudes des femmes en général.

Le mouvement pour l'enlèvement du tchartchaf et de la voilette prend des grandes dimensions en 1951 à la promulgation de la loi de l'interdiction du port de la voilette et du tharthaf comme résultat du mouvement en général des femmes progressives et de leur conscience sachant bien que le tchartchaf était un empêchement principal à leur émancipation.

⁶⁰ AK, AFŽ, K/6 (Raport).